



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2019

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISE SË PROKURIMIT PUBLIK

T I R A N Ë

NJOFTIMI I FITUESIT

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Për: **BOE “Ergi” sh.p.k & “Inerti” sh.p.k.** me adresë: lagjja 28 Nëntori, Autostrada Elbasan - Metalurgji, km 3, Elbasan.

Procedura e prokurimit: **“Proçedurë e Hapur”**.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-19741-04-25-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Jorgji Dilo” me fond limit: 105,348,164 (njëqind e pesë milion e treqind e dyzet e tetëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa t.v.sh,** vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan dhe Buxheti i Shtetit për vitin 2019 dhe 2020, dhe me afat për kryerjen e punimeve **5 (pesë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [data] [nr]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në proçedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE “Ergi” sh.p.k me Nipt: K 02727229 P & “Inerti” sh.p.k. me Nipt: J 66926804 L

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **102,739,096** (njëqind e dymilion e shtatëqind e tridhjetë e nëntëmijë e nëntëdhjetë e gjashtë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **121,760,214** (njëqind e njëzet e një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetëmijë e dyqind e katërbëdhjetë) **lekë** (me tvsh).

2. “Air Komponent” sh.p.k. me Nipt: L 38820501 I

Nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

3. “Elda - VL” sh.p.k. me Nipt: K 67106202 W

Nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

4. “BE - IS” sh.p.k me Nipt: K 71412003 A

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **78,679,485** (shtatëdhjetë e tetëmilion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntëmijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **94,931,242** (nëntëdhjetë e katërmilion e nëntëqind e tridhjetë e njëmijë e dyqind e dyzet e dy) **lekë** (me tvsh).

5. BOE “Kacdedja” sh.p.k me Nipt: K 51712017 A & "Agri Konstruksion" sh.p.k. me Nipt: K 01725001 F

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **79,685,747** (shtatëdhjetë e nëntëmilion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesëmijë e shtatëqind e dyzet e shtatë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **94,542,237** (njëqind e njëzet e njëmilion e tetëqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e dyqind e dyzet e nëntë) **lekë** (me tvsh).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “Air Komponent” sh.p.k. me Nipt: L 38820501 I

2. Operatori ekonomik “Elda - VL” sh.p.k. me Nipt: K 67106202 W

3. Operatori ekonomik “BE - IS” sh.p.k me Nipt: K 71412003 A

4. BOE “Kacdedja” sh.p.k me Nipt: K 51712017 A & "Agri Konstruksion" sh.p.k. me Nipt: K 01725001 F

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “Air Komponent” sh.p.k skualifikohet për arsye se : nuk ka paraqitur oferte ekonomike si dhe dokumentacionin ligjor , ekonomik-financiar dhe teknik ne permbushje te kriterëve te DST-se.

2. Operatori ekonomik “Elda - VL” sh.p.k skualifikohet për arsye se : nuk ka paraqitur oferte ekonomike si dhe dokumentacionin ligjor , ekonomik-financiar dhe teknik ne permbushje te kriterëve te DST-se.

3. Operatori ekonomik “BE - IS” sh.p.k skualifikohet për arsye se:

a) Operatori Ekonomik ne permbushje te pikes 2.3.17. te Kapacitetit Teknik : Operatori ekonomik duhet te paraqese kontrate paraprake furnizimi per listen e mallrave te percaktuara

ne preventiv bojera, materiale elektrike , hidraulike, sistemi i ngrohjes, te pajisura ISO 9001-2015 (Sistemi i Menaxhimit te Cilesise), te prodhuesit. Kontrata duhet te permbaje te dhenat e plota te prodhuesit, distributorit, te nevojshme per verifikim nga Autoriteti kontraktor ne rast verifikimi.

Ne permbushje te ketij kriteri, OE "BE-IS" sh.p.k. nuk ka paraqitur asnje kontrate furnizimi per listen e mallrave te lartpermendura.

b) OE "BE-IS" sh.p.k nuk ka paraqitur kontrate per depozimin e mbetjeve/inerteve me landfill brenda Bashkise Elbasan.

c) Operatori Ekonomik ne permbushje te pikes 2.3.1 te Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

- Punë të ngjashme të së njëjtës natyrë për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se **52,674,082** (pesedhjetë e dymilion e gjashtëqind e shtatedhjetë e katermije e tetedhjetë e dy) **lekë pa t.v.sh.**, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit të tenderit;

OSE

-Punë të ngjashme ku vlera totale e punës së tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit të tenderit, është një vlerë jo më e ulët se **210,696,328** (dyqind e dhjetemilion e gjashtëqind e nentedhjetë e gjashtëmije e treqind e njezet e tete) **lekë pa t.v.sh.;**

Operatori ekonomik "BE-IS" sh.p.k. ka deklaruar kontrata te puneve te ngjashme ku vlera totale e puneve te kryera gjate tre viteve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit, eshte **178,468,089** (njeqind e shtatedhjetë e tetemije e katerqind e gjashtedhjetë e tetemije e tetedhjetë e nente) **leke pa tvsh.**, pra operatori nuk e permbush kete pike te kriterit te vecante te kualifikimit, ku vlera totale e puneve te ngjashme duhet te ishte **210,696,328** (dyqind e dhjetemilion e gjashtëqind e nentedhjetë e gjashtëmije e treqind e njezet e tete) **lekë pa t.v.sh.** Gjithashtu asnjera nga kontratat e paraqitura per nje objekt te vetem nuk e arrin vleren **52,674,082** (pesedhjetë e dymilion e gjashtëqind e shtatedhjetë e katermije e tetedhjetë e dy) **lekë pa t.v.sh.**

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se : "[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...]"

"Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar parashikohet se "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë

ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Sa mësipër, komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

4. BOE “Kacdedja” sh.p.k & "Agri Konstruksion" sh.p.k. skualifikohet për arsye se:

a) Operatori Ekonomik ne permbushje te pikes 2.3.6. te Kapacitetit Teknik : Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar si ing/staf teknik te pajisur me certifikata te sigurimit teknik ose certifikata ekuivalente te cilat te jene te leshuara nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, nder te tjera, konkretisht minimumi:

- Teknik ndertimi 2
- Elektracist 3...
- Bojaxhi 2

Operatori qe ka marre persiper te kryeje punimet elektrike, bazuar ne akt-marreveshjen ndermjet dy shoqerive, eshte shoqeria "Kacdedja" sh.p.k. Ky operator ne permbushje te ketij kriteri ka paraqitur 3 (tre) punonjes elektriciste konkretisht : 1. Gejnoj Sata, 2. Sazan Darsi dhe Nik Hysa. Referuar listepagesave te shoqerise “Kacdedja” sh.p.k te paraqitura ne Sistemin e Prokurmit Elektronik per muajin e fundit, si dhe bazuar ne VKM nr.514, date 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR" rezulton se:

1. Gejnoj Sata, me kod 7115.02 figuron te jete karpentier dhe Nik Hysa , me kod 7131.07 figuron te jete bojaxhi.
2. Indrit Kodra dhe Gezim Haka te paraqitur nga OE si hidroizolues , me kode perkatesisht 8332.11 dhe 7112.03 figurojne te jene manovrator dhe murator.
- 3.Operatori Ekonomik "Agri Konstruksion" sh.p.k. ne permbushje te pikes 6 te kapacitetit teknik, ka paraqitur dokumentacion jo te plote ne lidhje me punonjesit bojaxhi, pasi mungon faqja e dyte e deshmive te kualifikimit te sigurimit teknik ne te cilen dallohet afati i vlefshmerise se ketyre deshmive.

b) Operatori Ekonomik ne permbushje te pikes 2.3.9. te Kapacitetit Teknik : Operatori ekonomik te kete ne stafin e tij 2 punonjes te pajisur me certifikate per ndihmen e pare dhe 1 (nje) ekspert per nderhyrjen ndaj emergjencave”,e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

Asnje nga Operoret e ketij bashkimi nuk ka paraqitur dokumentacion ne permbushje te ketij kriteri.

c) Operatori Ekonomik ne permbushje te pikes 2.3.17. te Kapacitetit Teknik : Operatori ekonomik duhet te paraqese kontrate paraprake furnizimi per listen e mallrave te percaktuara ne preventiv bojera, materiale elektrike , hidraulike, sistemi i ngrohjes, te pajisura ISO 9001-

2015 (Sistemi i Menaxhimit te Cilesise, te prodhuesit. Kontrata duhet te permbaje te dhenat e plota te prodhuesit, distributorit, te nevojshme per verifikim nga Autoriteti kontraktor ne rast verifikimi.

Ne permbushje te ketij kriteri, OE "Kacdedja" sh.p.k. ka paraqitur kontrate furnizimi me shoqerine "Dast" sh.a. Çertifikata **ISO 9001: 2015** "Sistemet e menaxhimit te cilesise", i ka kaluar afati i vlefshmërisë me datë skadimi 05.02.2019, duke e bërë këtë certifikatën të pavlefshme.

Gjithashtu certifikatat e cilesese te prodhuesit (GRUPO STN CERAMICA) jane ne gjuhe te huaj, te paperkthyer ne gjuhen shqipe ne kundershtrim me DST sipas te cilave, dokumentacioni i ofertes duhet te jete ne gjuhen shqipe.

d) Operatori Ekonomik "Agri Konstruksion" sh.p.k ne permbushje te pikes 2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë, referuar ekstraktit historik QKB, ka ushtruar aktivitet ne qytetin e Beratit, por nuk ka paraqitur asnje vertetim nga bashkia e Beratit qe ka taksat dhe tarifat vendore per vitin 2017.

e) Operatori Ekonomik "Agri Konstruksion" sh.p.k. ne permbushje te pikes 3 te kapacitetit teknik, **kontratat e punes per te gjithë stafin e inxhinierëve nuk jane noteriale.**

f) Asnje nga Operatoret Ekonomike "Agri Konstruksion" sh.p.k. dhe "Kacdedja" sh.p.k. nuk ka paraqitur kontrate per depozimin e mbetjeve/inerteve me landfill brenda Bashkise Elbasan.

g) Asnje nga Operatoret Ekonomike "Agri Konstruksion" sh.p.k. dhe "Kacdedja" sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacionin ne permbushje te pikes nr. 13 te kapacitetit teknik. {Licençe per Veprimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis (Auditim mjedisor ndikim ne mjedis) Kodi III.2.A (1+2)}.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se : "[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...]"

"Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar parashikohet se "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë

ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Sa mësipër, komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **BOE “Ergi” sh.p.k & “Inerti” sh.p.k.** me adresë: lagjja 28 Nëntori, Autostrada Elbasan - Metalurgji, km 3, Elbasan, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **102,739,096** (njëqind e dymilion e shtatëqind e tridhjetë e nëntëmijë e nëntëdhjetë e gjashtë) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve Publike)**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pese) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktor do të anullovë procedurën, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 11.06.2019

Ankesa nuk ka patur.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
Zv.Kryetari
Vesa Liço**